

DION Energji sh.p.k

Ne kete Statut:

- "Ligji" eshte ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregaret dhe Shoqerite tregtare",
- "Statuti" eshte statuti i shoqerise;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot me 15.05.2018, themeluesi ka krijuar nje shoqeri me pergjejsi te kufizuar me emrin **DION Energji SH.P.K.**
- (2) Themelues te Shoqerise eshte Shkumbin Qormemeti me te dhenat me poshte:
 - Numri i identifikimit: I10709194P
 - Vendlindja: MKD
 - Vendbanimi: Tirane, Shqiperi

Neni 2:

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem;

- Shoqëria ka për objekt kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:
- Aktivitet ekonomik në energji, import eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice te energjise elektrike, mallrave, certifikatave të gjelbëra dhe gazit; ndërmjetësim në fushën e tregtisë së mallrave dhe ndërmjetësim në lidhjen e kontratave mes kompanive private, dhe mes kompanive private dhe institucioneve shtetërore.
- Projektme dhe punime inxhinierike, studime te ndryshme profesionale qe mbulojne fusha te punimeve civile dhe te punimeve ne fushen e energjise.
- Zhvillimin dhe realizimin e ndërtesave, rrugëve, urave, autostradave, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, linjave nëntokësore e mbitokësore për energjinë dhe telekomunikacionin, centralet dhe hidrocentralet, nestacioneve transformuese, instalimin e paisjeve elektrike dhe te sistemeve te matjes, te sistemeve SCADA, objekte turistike, rrjeteve inxhinierike, objekteve industriale realizimin e studimeve urbane, kryerjen e te

SH.Q

gjitha restaurimeve. Kryerjen e projekteve në funksion të marrjes së lejeve të ndërtimit/zhvillimit; kontraktimin e shoqërive të projektimit/ndërtimit dhe shtiblerje,.

- Zhvillimin, realizimin, operimin dhe mbirmbajtjen e veprave energjitike ku futen dhe centralet e prodhimit të energjise nga burimet konvencionale dhe të rinovueshme, energjia djellore, energjia e eres, energjia nga burimet hidrike.
- Ofrimin e asistences teknike për realizimin e projekteve të cilat përfshijnë punime për zhvillimin e ndërtesave, rrugëve, urave, autostradave, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, linjave nëntokësore e mbitokësore për energjinë dhe telekomunikacionin, centralet dhe hidrocentralet, burimeve konvencionale dhe ato të rinovueshme të energjise përfshirë energjine djellore, energjine e eres dhe hidrike, nestacioneve transformuese, instalimin e paisjeve elektrike dhe e sistemeve të matjes, sistemeve SCADA, objekte turistike, rrjeteve inxhinierike, objekteve industriale realizimin e studimeve urbane, kryerjen e të gjitha restaurimeve.
- Ofrimin e asistences teknike me qëllim të marrjes së lejeve të ndërtimit/zhvillimit; kontraktimin e shoqërive të projektimit/ndërtimit dhe shtiblerje. Ofrimin e asistences teknike për perkthimin e dokumentacioneve teknike.
- Realizimin e projekteve konçesionare dhe/ose partneritet publik privat me institucione të pushtetit qëndror dhe autoriteteve të vetqeverisjes vendore, në fusha të shërbimit të transportit, menaxhimit të hapësirave publike dhe reklamave, projekteve të mbetjeve të ngurta, menaxhim projektësh në sektorin turistik dhe në çdo fushë tjetër ku institucionet përkatëse kanë kompetenca; asistencë shoqërive tregtare dhe/ose institucioneve publike në kryerjen e procedurave konçesionare dhe/ose partneriteteve publike/private.
- Ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit të marrëveshjeve mes shoqërive tregtare (shqiptare dhe të huaja), ndërmjetësimin e shoqërive tregtare në marrëdhëniet kontraktore mes tyre; asistencë në marrëdhënie me institucione financiare private dhe shtetërore.
- Pjesëmarrje me kuota/aksione në shoqëri tregtare, kryerja e investimeve në shoqëri shqiptare dhe të huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqërive dhe asistencë në veprimtarinë e tyre.
- Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- Shoqëria, me vendim të Asamblesë mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

Neni 3:

Kohezgjatja e shoqërisë është e papercaktuar.

Neni 4:

Selia

- (1) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen me poshte;

DION Energji SH.P.K.

Rruga Bogdani, pallati 32, shkalla 1, apartamenti 51

Njesia Administrative 5

Tirane, Shqiperi

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 000 (nje qind mije) Leke.
(2) Ortaku themelues eshte Shkumbin Qormemeti: Zoterues i kuotes me vlere 100 000 (nje qind mije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjisi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashgimise;

SH.Q

- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te trasferueshme nepermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashgimie.

KREU III

ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendim - marres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendim-marres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendim-marres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjitheshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme;

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) Ndryshimin e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) Emerimin e shkarkimin e likujdusve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Perfaqsimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- m) Ceshtje te tjera te miratuara nga lidhi apo statuti.

Ortaku mund te perfaqsohet ne asamblene e pergjitheshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqses i ortakeve ne asamblene e pershitheshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjitheshme, e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjitheshme

Asambleja e pergjitheshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjitheshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vleshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime pavarsisht parregullise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjitheshme mund te marre vendime te vleshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% (per qind) te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjitheshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vleshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjitheshme num mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e pergjitheshme vendos me tri te katertat e votive te zoteruesve te kapitalit, te organeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjitheshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) Percaktimin e shperblimeve;
- e) Mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqersimet e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjitheshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij;
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - c) Ngritjen e ndonje padije ndaj tij nga shoqeria;
 - d) Dhenien ose jot e perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqsoes i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te nejtin konflikt interesi ashtu si dhe ortaku te cilin perfaqson.

Neni 13

Administrimi

1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas pervaktimeve te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administrator ten je shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavleshem.
3. Personat e meposhtem caktohen si administrator te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e asamblese se pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:

dhe specimenet e nenshkrimit:

Emri, Mbiemri: Spartak Isakaj

Nr. Identifikimit: H50421199R

Adresa: Tirane, Shqiperi



Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqsojne shoqerine tregtare
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe saportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjitheshme per miratim;

- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe egzistencen e shoqerise;
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rejstrimit;
- g) Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) Kryejne detura te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur;

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjeteme financiare, rezulton ose egziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kekrkueshme Brenda 3 muajeve ne vazhdim.
 - Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter active, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % (per qind) e aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - Shoqeria Brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % (per qind) te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.
- Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdomkohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te mardhenieve kontraktore me shoqerine, rregulohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjsite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes inividualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e mareveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere mareveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17, 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" administrator detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresii, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqeris ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne dispozita;
- c) te vleresoje me pergjejsi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe te menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundeshem te interesave personale me ato te shoqerise;
- e) te ushtroj detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimt e shoqerise tregtare me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
3. Nese administrator vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale. Sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, elta.shte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administrator ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjijjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
4. Ne menyre te vecante po pa u kufizuar ne to, administrator eshte idetyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese ne kundersiztim me dispozitat e ligjit "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e meposhteme:
 - a) O kthen ortakeve kontributet;
 - b) U paguan ortakeve interesa apo dividende;
 - c) U shperndan aktivet e shoqerise;
 - d) Lejon qe shoqeris te vazhdoj veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendejs financiare, duhej te parashikohej qe shoqeris nuk kishte aftesi pagueuse per te shlyer detyrimet;
 - e) Jep kredi;

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire dhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojeshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloj ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti Financiar - Ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet ne 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko – tregtare te shoqerise, ate gjitha vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tia paraqese e dorzoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe;

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te asamblese se ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e) Me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaket marrin vendimin me shkrim ne te cilin parashikohet menyra e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij, emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne Likuidim e Siper”.

Prishja e shoqerive tregtare ka ssi pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrnin nje vendim per emerimin e likujduesve Brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i Shoqerise, bashkimi – ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjitheshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

SH.Q

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi civil dhe cfardo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, do te jene kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET

E SHOQERISE ME PERGJEGJSI TE KUFIZUAR

DION Energji

Shkumbin Qormemeti

